Ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve që trajtohet në landfill, incinerator, impiant kompostimi apo riciklimi, të cilat janë projektuar, ndërtuar si dhe operojnë dhe mirëmbahen në përputhje me standardet e aprovuara nga institucionet e nivelit qëndror. Besueshmëria e tij varet shumë nga metodat e përdorura për gjenerimin e të dhënave që përdoren për matjen e këtij indikatori (shiko pikat e mësipërme) si në formulën e mëposhtme:

$$Ind 3 = \frac{Sasia e mbetjeve te trajtuara ne impinte (\frac{ton}{vit})}{Sasia e mbetjeve te grumbulluara (\frac{ton}{vit})} \times 100$$

### 6.4 Indikatori 4 – Eficiencia në mbledhjen e tarifave

Ky indikator shpreh se sa është shkalla e realizimit të planifikimit në mbledhjen e tarifave. Ky indikator është i përcaktuar si përqindje e raportit të të ardhurave të grumbulluara në vitin aktual me totalin e të ardhurave të planikuara për këtë vit. Besueshmëria e tij varet shumë nga metodat e përdorura për gjenerimin e të dhënave që përdoren për matjen e këtij indikatori (shiko pikat e mësipërme) si në formulën e mëposhtme.

Ky indikator vlerësohet dy herë, nga vetë inspektorët e shërbimit në bashki dhe nga vlerësues monitorues jashtë bashkisë. Ai llogaritet si mesatarizim i pikëve të grumbulluara për çdo nën-komponent.

#### 6.7 Indikatori 7 – Kënaqësia e publikut

Ky indikator mund të llogaritet në dy mënyra:

- a) Matja e eficencës në adresimin e ankesave të klientëve:

$$Ind\ 7 = \frac{Numri\ i\ ankesave\ te\ adresuara\ per gjat\ nje\ viti}{Numri\ i\ ankesave\ te\ marra\ per gjate\ nje\ viti} \times 100$$

- b) Matja e shkallës së kënaqësisë së publikut për shërbimin e pastrimit. Kjo realizohet me anë të një pyetësori që është bashkëlidhur në aneksin e kësaj metodologjie.

#### 6.8 Indikatori 8 – Vlerësimi i rolit të bashkisë në cilësinë e shërbimit të ofruar

Ky është një indikator cilësor i përbërë, i cili është detajuar në 5 nën-komponentë, ku secili prej tyre vlerësohet me pikë sipas kriterieve të vlerësimit të përshkruar në tabelën e mëposhtme:

1	Plani lokal përmenaxhimin mbetjeve	Nëse bashkia nuk ka plan përmenaxhimin e mbetjeve Nëse bashkia ka një plan të pamiratuar nga Këshilli Bashkiak Nëse plani është i miratuar nga Këshilli Bashkiak Nëse plani është në koherencë me politikat kombëtare Nëse plani është i shoqëruar edhe me rregulloren e brendshme të menaxhimit të mbetjeve të miratuar në Këshillin Bashkiak	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
2	Zbatueshmëria planit	Nëse raporti i aktiviteteve të zbatuara me ato të planifikuara në planin lokal të menaxhimit të mbetjeve është < 30% Nëse raporti i aktiviteteve të zbatuara me ato të planifikuara në planin lokal të menaxhimit të mbetjeve është 31 - 40 % Nëse raporti i aktiviteteve të zbatuara me ato të planifikuara në planin lokal të menaxhimit të mbetjeve është 41 - 60 % Nëse raporti i aktiviteteve të zbatuara me ato të planifikuara në planin lokal të menaxhimit të mbetjeve është 61 - 80 % Nëse raporti i aktiviteteve të zbatuara me ato të planifikuara në planin lokal të menaxhimit të mbetjeve është > 81 %	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
3	Struktura organizative	Nëse bashkia ka vetëm një person përgjegjës përmenaxhimin e mbetjeve Nëse bashkia ka një strukturë me të paktën 3 persona (sektor) Nëse bashkia ka një departament me disa sektore/me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara Nëse të gjitha vendet e strukturës janë të plotësuara me staf të përshtatshëm për atë pozicion Nëse stafi trajnohet të paktën 2 herë në vit për çështjet e menaxhimit të mbetjeve	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë
4	Ekzistenza e të dhënave përmjet / databazë	Bashkia ka evidenca të matjes ditore mujore të sasisë së grumbulluar të mbetjeve, por jo një databazë, ku rregjistrohet çdo ditë/muaj këto të dhëna Bashkia ka një rregjistër përmjet dhënave, por të fragmentuar, jo të plotësuar të papërditësuar Bashkia kryen matje dhe vlerësimë në mënyrë të rregullt të sasisë së gjeneruar të mbetjeve, përbërjes mercologjike, sasisë së grumbulluar, të ricikluar & trajtuar	0 pikë 5 pikë 10 pikë 15 pikë 20 pikë

**PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E KËNAQËSISË QYTETARE PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË  
BASHKINE**

Bashkia	Njësia administrative	Data e intervistës	Nr. i pyetësorit
.....	.....	.....	.....

Ky pyetësor realizohet nga Bashkia [REDAKTUE] dhe ka si qëllim të vlerësoje shkallën e kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e pastrimit të ofruar nga Bashkia [REDAKTUE]. Përgjigjet Tuaja janë konfidenciale, dhe nuk do të publikohen apo nuk do të përdoren për asnjë qëllim tjetër përvèçse për të vlerësuar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

**1. A ofrohet shërbimi i grumbullimit, transportit dhe pastrimit te rrugeve në zonën ku ju banoni?**

- |      |      |
|------|------|
| a Po | b Jo |
|------|------|

1.1. Nëse po, sa të kënaqur jeni ju me cilësinë e shërbimit të pastrimit në zonën ku ju banoni?

- |                    |                      |                |
|--------------------|----------------------|----------------|
| a Shumë të kënaqur | b Të kënaqur         | c Neutral      |
| d Të pakënaqur     | e Shumë të pakënaqur | f Tjetër _____ |

1.2. Nese jo cilit prej alternativave të mëposhtme ju mendoni që ndikonë më shumë në cilësinë aktuale të shërbimit të pastrimit në zonën ku ju banoni?

- |  |  |   |
|--|--|---|
| a Nr i konteniereve nuk është i mjaftueshëm      | b Frekuanca shërbimit nuk është e mjaftueshme                | c Kontenieret tejmbushen nga bizneset e zonës |
| d Qytetaret i hedhin mbetjet jashtë konteniereve | e Aktiviteti i legal grumbulluesëve mbetjeve tē riciklueshme | f Tjetër _____                                |

2. A është i mjaftueshëm numri i kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën ku ju banoni?

- |      |      |                |
|------|------|----------------|
| a Po | b Jo | c Tjetër _____ |
|------|------|----------------|

3. Sipas informacionit që ju keni, sa herë ndodh mbledhja e mbetjeve në zonën ku ju banoni?

- |                  |                  |                         |
|------------------|------------------|-------------------------|
| a Çdo ditë       | b 2 herë në dite | c Sa here _____ në javë |
| d Nuk ka rregull | e Nuk e di       | f Tjetër _____          |

4. Sipas mendimi tuaj si do të vlerësonit, Ju shkallën e pastërtisë së rrugëve dhe shesheve kryesore në bashkinë tuaj?

- |                    |             |           |
|--------------------|-------------|-----------|
| a Shumë tē pastërt | b Të pastra | c Neutral |
|--------------------|-------------|-----------|

10. Sipas mendimit tuaj cilat prej masave të mëposhtme Bashkia duhet të ndërmarrë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit? Ju lutemi zgjidhni nga 1 deri ne 3 nga alternativat e mëposhtme duke i renditur sipas rëndësisë duke filluar nga 1 si më e rëndësishmja:

a	Të rrisë frekuencen e ofrimit te shërbimit	d	Të ofrojë infrastrukturën përgrumullimin e diferencuar të mbetjeve
b	Të shtojë numrin e punitoreve që mirëmbajnë rrugët dhe sheshet kryesore	e	Të rrisë tarifën e pastrimit për të financuar një shërbim më të mirë
c	Të shtoje numrin e konteniereve dhe koshave rrugore	f	Të intensifikojë komunikimin me qytetarët dhe bizneset përmes fushatave të informimit dhe sensibilizimit
g Tjeter			

Duke ju falenderuar për pergjigjet, në përfundim të këtij pyetësori do të dëshironim të kishim një vlerësim final nga Ju për cilësinë e shërbimit të pastrimit për bashkinë Shkodër. Nga 1 deri tek 10 cilën notë do ti jepnit këtij shërbimi?

Aneks II – Formularët që mund të përdroen nga bashkitë për të kërkuar raportime të rregullta nga kompanitë që merren me grumbullimin dhe trajtimin e rrymave specifike të mbetjeve.

#### I. Formulari për të dhënat për ambalazhin e hedhur në treg

1. Të dhënat për ambalazhin e hedhur në treg: _____ datë _____				
2. Të dhënat për prodhuesin: Kompania _____; Personi i Kontaktit _____; Adresa: _____				
3. Të dhënat për llojin dhe sasinë e ambalazhit që është hedhur në treg				
Lloji i materialit të ambalazhit	Sasia e hedhur në treg (kg/vit)	Sasia e ambalazhit të hedhur në treg-njësia e ambalazhit (copë)	Sasia e ambalazhit të eksportuar (kg/vit)	Sasia e ambalazhit të importuar (kg/vit)
Qelq				
Metal				
Letër/ Karton dhe ambalazh shumë shtresor				
Plastikë				
Dru				
Amabalazh prej materialeve të tjera				
Personi përgjegjës për të dhënat: _____				

#### II. Formulari për të dhënat për ambalazhin e grumbulluar dhe çuar në përpunim, riciklim

1. Të dhënat për ambalazhin e grumbulluar dhe çuar në përpunim, riciklim: _____ datë _____
2. Të dhënat për prodhuesin: Kompania _____; Personi i Kontaktit _____; Adresa: _____
3. Të dhënat për llojin dhe sasinë e ambalazhit që është hedhur në treg

	(kg/vit)	(kg/vit)	tjera të përpunimit (kg/vit)	
Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe prishjet (jo të rrezikshme)				
Mbetje ndërtimi dhe prishjeve që përbajnjë mërkur (Hg)				
Mbetje ndërtimi dhe prishjeve që përbajnjë PCB				
Mbetje nga ndërtimi dhe të prishjeve, duke përfshirë mbetjet e përziera që përbajnjë substanca të rrezikshme				
Total				
Personi përgjegjës për të dhënat:				

#### IV. Formularë për të dhënat për sasinë e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike që gjenerohen nga subjekti: datë				
2.Të dhënat për operatorin: Kompania _____; Personi i Kontaktit _____; Adresa: _____				
3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike				
Kodi i mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike 16 02 / 20 01 36	Sasia e përgjithshme e gjeneruar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar përi ripërdorim (kg/vit)	Sasia përmënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e Ekspортuar (kg/vit)
Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike				
Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike - Mbetje të tubave fluorishente dhe mbetje të tjera që përbajnjë mërkur (mbetje të rrezikshme)				
Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike Pajisje skarco që përbajnjë klorofluorokarbone (mbetje të rrezikshme)				
Total				
Personi përgjegjës për të dhënat:				

1. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike që grumbullohen dhe trajtohen nga subjekti: datë				
2.Të dhënat për operatorin: Kompania _____; Personi i Kontaktit _____; Adresa: _____				
3. Të dhënat për sasinë e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike				

Bateri plumbi (të rrezikshme)				
Elektrolite të ndara të mbledhur nga bateri dhe akumulatorë të tjera (të rrezikshme)				
Total				
Personi përgjegjës për të dhënat:				

#### VI. Formularë për të dhënrat për sasinë e mbetjeve nga vajrat e përdorur

1. Të dhënrat për sasinë e mbetjeve nga vajrat e përdor që grumbullohen dhe trajtohen nga subjekti: datë				
2. Të dhënrat për operatorin: Kompania _____; Personi i Kontaktit _____; Adresa: _____				
3. Të dhënrat për sasinë e mbetjeve nga vajrat e përdorur:				
Kodi i mbetjeve nga vajrat e përdorur 12 01 06 / 12 01 10	Sasia e përgjithshme e grumbulluar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar përi ripërdorim (kg/vit)	Sasia përmënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e Eksportuar (kg/vit)
Vajrat minerale të makinerive që përbajnë halogjenë (përveç emulsioneve dhe solucioneve) (të rrezikshme)				
Vajrat sintetik të makinerive (të rrezikshme)				
Total				
Personi përgjegjës për të dhënat: _____				

#### VII. Formularë për të dhënrat për sasinë e mbetjeve nga gomat e dala jashtë përdorimit

1. Të dhënrat për sasinë e mbetjeve nga gomat e dala jashtë përdorimit që grumbullohen dhe trajtohen nga subjekti: _____ datë				
2. Të dhënrat për operatorin: Kompania _____; Personi i Kontaktit _____; Adresa: _____				
3. Të dhënrat për sasinë e mbetjeve nga gomat e dala jashtë përdorimit:				
Kodi i mbetjeve nga gomat e dala jashtë përdorimit 16 01 03/ 400 000 00	Sasia e përgjithshme e grumbulluar (kg/vit)	Sasia që ka shkuar përi ripërdorim (kg/vit)	Sasia përmënyra të tjera të përpunimit (kg/vit)	Sasia e Eksportuar (kg/vit)
Gomat jashtë përdorimit				
Total				
Personi përgjegjës për të dhënat: _____				

#### VIII. Formularë për të dhënrat për sasinë e mbetjeve nga produktet e kafshëve

1. Të dhënrat për sasinë e mbetjeve nga produktet e kafshëve që gjenerohen nga subjekti: datë				
2. Të dhënrat për operatorin: Kompania _____; Personi i Kontaktit _____; Adresa: _____				
3. Të dhënrat për sasinë e mbetjeve nga produktet e kafshëve:				

# RELACION SHPJEGUES

## PËR PROJEKTVENDIMIN

### “PËR

NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 687, DATË 29.7.2015 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR MBAJTJEN, PËRDITËSIMIN DHE PUBLIKIMIN E STATISTIKAVE TË MBETJEVE”

### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRİHEN.

Mungesa e një procesi të koordinuar dhe të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të dhënave të mbetjeve (*data bazë për të dhënat dhe statistikat e mbetjeve në zyrat e bashkive*), ka sjellë një situatë kaotike, duke mos i krijuar mundësinë çdo NjVQV-ve që të masë cilësinë e shërbimit që ato ofrojnë në territoret e tyre përmes llogaritjes të indikatorëve të performancës. Pra **vlerësimi i performancës së shërbimit** dhe rrjedhimisht zbatimi i ligjit për vetëqeverisjen vendore (*neni 30*) bëhet i mundur **vetëm nëse ekzistojnë të dhëna të prodhua**ra sipas të njëjtës metodologji në çdo NjQV, të grumbulluara në mënyrë të rregullt dhe periodike.

Hartimi i këtij projekt akti realizohet me qëllim të përfshijë si aneks te saj dhe detyrimin e NjVQV-ve për zbatimin e metodologjisë për grumbullimin dhe prodhimin e dhënave për menaxhimin e mbetjeve.

Kjo metodologji synon të plotësojë këtë boshllék të VKM-së 687/2015, duke lehtësuar procesin e raportimit të treguesve të parashikuar për t'u raportuar çdo vit nga NjQV-të.

Metodologjia për gjenerimin e dhënave, do i mundësojë NjQV-të të instalojnë një data bazë të unifikuar për të dhënat për kategoritë e ndryshme të mbetjeve që prodhohen, grumbullohen, transportohen dhe trajtohen në territorin e tyre, si dhe plotësimin e tre objektivave kryesore në rang kombëtarë si:

- i. Mundësimin e një burim koherent të informacionit për vendimmarrësit për planifikimin e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve si dhe për monitorimin e objektivave kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- ii. Vendosjen e një sistemi *benchmark-u* për matjen e performancës së shërbimit të ofruara nga bashkitë në territoret e tyre përmes llogaritjes së tregueseve të performancës.

- iii. Lehtësimin e procesit të integrimit në BE, duke kontribuar në krijimin e një platforme të unifikuar për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për mbetjet, e cila do të përmirësonë për NjQV-të sistemet e planifikimit dhe raportimit.

Vendimi nr. 687/2015 i detyron Njësitet e Qeverisjes Vendore (NJQV), që sipas shtojcës nr. 3, të bëjnë raportimin e tregueseve të mëposhtëm brenda datës 31 Janar të çdo viti.

Nr.	Informacioni i kërkuar	Kodi i katalogut Shqiptar	Shënimë
1	Sasia e mbetjeve		Të dhënat për planifikimin e menaxhimit të mbetjeve
2	Sasia e mbetjeve për person/kg/vit		
3	Sasia e mbetjeve shtëpiakre kg ose ton/vit	20	
4	Sasia e mbetjeve inerte kg ose ton/vit	17 09 04	Të dhënat për trajimin e mbetjeve
5	Sasia e mbetjeve spitatore kg ose ton/vit	18 01 10	
6	Sasia e mbetjeve të depozituara në landfil (ton/vit)		
7	Sasia e mbetjeve të depozituara në incenerator (ton/vit)		
8	Sasia e mbetjeve plastike kg ose ton/vit	17 02 03 / 15 01 02	Të dhënat për erumbullimin e diferencaudicë mynë specifike
9	Sasia e mbetjeve të gelatikg ose ton/vit	15 01 07	
10	Sasia e mbetjeve metalike kg ose ton/vit	17 04 07 / 15 01 04	
11	Sasia e mbetjeve të druri ton/m <sup>3</sup>	17 02 01 / 15 01 03	
12	Sasia e mbetjeve të letres dhe kartonit kg ose ton/vit	15 01 01 / 03 03 08	
13	Sasia e mbetjeve të baterive të data jashtë përdorimit	16 06 / 16 06 01 / 16 06 06	
14	Sasia e mbetjeve të gomave të data jashtë përdorimit kg ose ton/vit	16 01 03 / 400 400 00	
15	Sasia e mbetjeve të vajave të përdorur kg ose ton/vit	12 01 06 / 12 01 10	
16	Sasia e mbetjeve nga produkte e katërvje kg ose ton/vit	02 01 02	
17	Sasia e mbetjeve të produkteve të tekstilit kg ose ton/vit	04 04 / 15 09 01	
18	Sasia e mbetjeve elektrike dhe elektroonike kg ose ton/vit	16 02 / 20 04 36	

Këto të dhëna duhet të prodhohen nga: (i) sistemi i monitorimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve i instaluar në bashki (ii) raportimi periodik i operatorëve të shërbimit që ofrojnë shërbimin e pastrimit në çdo bashki, (iii) nga raportimi i inspektorëve bashkiakë që mund të jenë në impiantet e trajtimit (iv) nga vëzhgimet që mund të ndërmarrin bashkitë për të matur prodhimin e mbetjeve për banorë dhe përbërjen merceologjie të tyre; dhe v) nga raportimet vjetore të bizneseve që merren me prodhimin, përpunimin, importin apo eksportin e fraksioneve të ndryshme të mbetjeve që raportojnë në bashki.

Gjithsesi, që nga hyrja në fuqi e VKM-se 687/2015, NjQV-të kanë shprehur shqetësimin përmes mungesën e informacionit dhe të një metodologjje përmes mënyrën se si duhet t'i gjenerojnë këto të dhëna. Në shumicën e rasteve, raportimi i bërrë nga NjQV-të është i pjesshëm (*jo rrallë herë NjQV-të përmes shumicën e tregueseve pothuajse nuk raportojnë asnjë vlerë*) si pasojë e mungesës së evidencave dhe një regjistri të përditësuar të përvitshëm përmes mbetjet. Përmes tepër, edhe në rastet kur raportohet (*kur NjQV-të mundohen të prodhojnë të dhëna në mënyra të ndryshme*), sërisht treguesit e raportuar janë të dyshimtë dhe shumë pak të krahasueshëm ndërmjet tyre (*të dhënat nuk prodhohen nga NjQV-të sipas të njëjtës metodologji*).

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.**

Ky projekt akt është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës. Ai propozohet në bazë të delegimit të parashikuar në nenin 60, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Përmes menaxhimit e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar si dhe hartoherë në përputhje me programin analistik të akteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të planifikuara përvitin 2021.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKT-AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.**

Pas hyrjes në fuqi të ligjit 10463/2011 “Përmes menaxhimit e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ku u prezantua detyrimi përmes ruajtjen dhe përditësimin e statistikave të mbetjeve nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit (*neni 60*), janë miratuar disa akte nënligjore, ku janë përcaktuar aktorët dhe të dhënat e mbetjeve që duhet të mblidhen dhe raportohen. Një nga këto akte nën ligjore është edhe *VKM nr. 687 datë 29.07.2015 “Përmiratimin e rregullave përmblidjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”*, e cila

përcakton aktorët, të cilët kanë detyrimin për raportimin e një sërë të dhënavë për mbetjet tek AKM-ja apo Ministritë përkatëse të linjës. Qartësisht VKM-ja dikton që burimi kryesor i të dhënavë janë bashkitë, ku në shumicën e rasteve këto të dhëna mbahen nga kompanitë private që ofrojnë shërbimin ose ndërmarrjet publike të vetë bashkive, ose nga bizneset që operojnë në territorin e bashkive. Edhe pse, palët e interesuara përgjegjëse për procesin, dhe të dhënat specifike të mbetjeve që duhet të mblidhen janë përcaktuar, mungesa e një metodologjje për mënyrën e gjenerimit dhe grumbullimit të të dhënavë për mbetjet, e bën këtë VKM pothuajse të pazbatueshme nga ana e njësive të vetqeverisjes vendore (NVQV) për të mundësuar të dhëna sa më të sakta, të besueshme dhe mbi të gjitha të krahasueshme.

Nisur nga kjo situatë, VKM-ja aktuale për statistikat e mbetjeve ka hapur vetëm një dritare, ku ka përcaktuar aktorët dhe rrymat mbetjeve, për të cilat ata duhet të raportojnë, por nuk ka qartësuar se si duhet të gjenerohen këto të dhëna, duke marrë në konsideratë situatën e ofrimit të shërbimit në njësitë lokale në vend. Nevoja për amendimin e kësaj VKM-je, duke shtuar si aneks një metodologji për mënyrën e gjenerimit të të dhënavë të mbetjeve, do të lehtësonte mjafit punën e njësive vendore, duke unifikuar burimin e të dhënavë dhe metodologjinë për gjenerimin e tyre, si dhe do t'i jepte mundësinë bashkive të kenë një databazë të unifikuar për të dhënat e mbetjeve që gjenerohen, grumbullohen, transportohen dhe trajtohen në territorin e tyre.

Qëllimi i metodologjisë është të mundësojë mënyrën se si gjenerohen dhe grumbullohen të dhëna të sakta dhe të besueshme për mbetjet.

Pra metodologjia jo vetëm do të udhëzojë njësitë e vetqeverisjes vendore me mënyrën se si mund t'i gjenerojnë të dhënat e tyre për mbetjet, por gjithashtu do të mundësojë që të gjitha NVQV të raportojnë këto të dhëna siç kërkohen, duke kontribuar gjithashtu në ngritjen e një sistemi krahasimi të dhëna midis bashkive, dhe klasifikimin e tyre.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.**

Ky projekt akt është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës si dhe propozohet në bazë të delegimit të parashikuar në nenin 60, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

Projektvendimi nuk transpozon asnjë direktivë të Bashkimit Evropian.

Ky projekt akt nuk synon miratimin e *Acquis* të Bashkimit Evropian, por ai është hartuar në përputhje me kërkesën e Nenit 3, pika 1 e Rregullores (KE) nr.

2150/2002 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 25 nëntor 2002, “Për statistikat e mbetjeve”; Nr. CELEX 32002R2150; Gazeta Zyrtare L 332, 09/12/2002, P.0001-0036.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE).

Ky projekt akt nuk synon përafrim të akteve s të Bashkimit Evropian, por ai është hartuar duke marrë në konsideratë kërkesën e nenit 3, pika 1 e Rregullores (KE) nr. 2150/2002 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 25 nëntor 2002, “Për statistikat e mbetjeve”; Nr. CELEX 32002R2150; Gazeta Zyrtare L 332, 09/12/2002, P.0001-0036.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT.

Projekt akti i propozuar përbëhet nga *një paragraf* si vijon:

*Paragrafi 1*, është përcaktuar detyrimi i njësive të qeverisjes vendore për zbatimin e metodologjisë për grumbullimin dhe prodhimin e të dhënavë për menaxhimin e mbetjeve, të përcaktuar në shtojcën 4 të këtij vendimi, për plotësimin e formatit të raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE STRATEGJIKE DHE PLANIT KOMBËTAR.

Për zbatimin e këtij projekt akti ngarkohen:

- a. ministria përgjegjëse për mjedisin,
- b. ministria përgjegjëse për infrastrukturën,
- c. ministria përgjegjëse për bujqësinë,
- d. ministria përgjegjëse për shëndetësinë,
- e. Agjencia Kombëtare e Mjedisit,
- f. Këshillat e Qarqeve dhe
- g. Njësitë e Qeverisjes Vendore sipas përcaktimit të pikës 8 të Vendimit nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.

## VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.

Hartimi i këtij projektvendimi është bërë me mbështetjen e ekspertëve të projektit “Bashki të Forta”, ku kanë kontribuar dhe punonjësit në:

- Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit,
- Institutin e Statistikave- INSTAT,
- Agjencinë Kombëtare të Mjedisit-AKM.

Ky projektvendim është hedhur në faqen e konsultimit publik në datën 26.02.2021 dhe do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe në Sekretariatin Teknik të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

## IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE.

Ky projektvendim nuk do të ketë efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, pasi zbatimi i tij është përllogaritur në buxhetin e ligjit kuadër të mbetjeve si dhe të vendimit ekzistues për statistikat e mbetjeve.

